



# MIDIS SFIDAVE DHE ZGJIDHJEVE

Udhëzues për  
integritetin e mediave  
në Maqedoninë e Veriut

Autore: dr. Marina Tuneva







# **MIDIS SFIDAVE DHE ZGJIDHJEVE**

Udhëzues për  
integritetin e mediave në  
Maqedoninë e Veriut

**Autore: dr. Marina Tuneva**

# PËRMBAJTJA

## 5 Hyrje

---

## 7 Metodologjia

---

## 9 Integriteti mediatic: ndikimet dhe sfidat

---

- 10 Interesat e politikës dhe biznesit ndikojnë në integritetin e mediave
  - 11 Reziqet nga reklamat shtetërore dhe politike
  - 16 Propozimi për qëndrueshmëri më të madhe të sektorit të mediave: fond për zhvillimin e mediave
  - 19 Barrierat socio-ekonomike e rrënojnë integritetin e mediave në Maqedoninë e Veriut
  - 21 Mediat online dhe mungesa e masave përkatëse rregullatore
  - 23 (Jo)profesionalizmi në redaksi dhe roli i vetërregullimit mediatic
  - 26 xxBarazia gjinore në media – progresi dhe sfidat
-



## **29 Gjetje nga intervistat dhe fokus-grupi sfidat, zbrazëtirat dhe mundësitë për përmirësimin e integritetit mediatik**

---

- 29** Integriteti mediatik – çfarë nënkupton kjo?
  - 31** Integriteti mediatik në vend është goditur rëndë
  - 33** Zbërthimi i sfidave në lidhje me integritetin në media
  - 36** Mediat online në tranzicion: sfidat rregullatore dhe ndërtimi i integritetit
  - 37** Roli i mediave në nxitjen e përfshirjes dhe përfaqësimit në Maqedoninë e Veriut
  - 38** Roli i mediave në luftën kundër korrupsionit: sfidat dhe përgjegjësitë
- 

## **41 Konkluzione**

---

## **43 Rruga drejt integritetit të mediave rekomandime**

---


- 44** Avancimi i integritetit të mediave: iniciativa për pavarësi dhe harmonizim me standardet europiane
  - 45** Reforma etike, arsimore dhe strukturore për gazetari të përgjegjshme
  - 46** Përmirësimi i kushteve socio-ekonomike dhe kornizës juridike
- 

## **49 BIBLIOGRAFIA**

---

## MIDIS SFIDAVE DHE ZGJIDHJEVE

UDHËZUES PËR INTEGRITETIN E MEDIAVE NË MAQEDONINË E VERIUT



# Hyrje

S sektori i mediave në Republikën e Maqedonisë së Veriut vazhdon të ballafaqohet me sfidat e tranzicionit digjital dhe ambientin e ndryshueshëm politik. Këto zhvillime po ndikojnë në mënyrë kritike në integritetin e mediave, të cilin Observatori i Medias i Europës Juglindore<sup>1</sup> e përkufizon si gërshetim i ndikimit të politikave, strukturave dhe praktikave që u mundësojnë mediave t'i shërbejnë interesit publik në mënyrë efektive dhe të mbështesin parimet demokratike.

Pjesë përbërëse e integritetit të mediave janë disa aspekte të cilat, në veçanti, përfshijnë:

- ▶ Përkushtimin për raportim të paanshëm dhe shmangien e ndikimit nga qendrat e fuqishme;
- ▶ Transparencën në angazhimin dhe interesat, duke përfshirë zbulimin e qartë të ekspozimit ose varësisë nga interesa konkrete private ose qeveritare;
- ▶ Respektimin e standardeve etike dhe profesionale;
- ▶ Përgjegjësinë dhe qasjen e hapur ndaj qytetarëve.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Petkovic, B. (2014). *Media Integrity Matters - Reclaiming Public Service Values in Media and Journalism*. Peace Institute Ljubljana. Në dispozicion në: <https://seenpm.org/media-integrity-matters-book-of-the-see-media-observatory/> Qasje prej dt. 11.10.2023.

Për përpilimin e këtij Udhëzuesi, para së gjithash, është kryer një hulumtim thelbësor dhe metodologjikisht i qëndrueshëm, që u fokusua në aspektet kryesore të integritetit të mediave në Maqedoninë e Veriut. Krahas analizimit të perspektivave dhe pikëpamjeve të palëve kryesore të interesuara, u analizuan edhe raporte dhe dokumente të ndryshme për të përcaktuar gjendjen rreth aspekteve të ndryshme të integritetit të mediave. Qëllimi i kësaj qasjeje ishte, fillimisht, të përcaktohen dhe të kuptohen ndikimet mbizotëruese ndaj praktikave mediatike dhe, më pas, të nxirren rekomandime relevante dhe efektive për përforcimin e integritetit të mediave në vend.

Rëndësia e këtij dokumenti qëndron në potencialin e tij për të shërbyer si një burim për politikëbërësit, profesionistët e mediave dhe publikun me njohuri mbi hapat e nevojshëm strategjikë për të kultivuar një mjedis mediatik që synon integritetin dhe vlerat demokratike. Duke pasur parasysh natyrën e ndryshueshme të mjedisit mediatik, dokumenti është

krijuar në një mënyrë që të lejojë që i njëjti të plotësohet dhe përshtatet në përputhje me rrethanat, si rezultat i kërkimeve të ardhshme në këtë fushë.

Nevoja për të krijuar besim në media është theksuar edhe në Raportin e Komisionit European për Progresin e Shtetit për vitin 2022<sup>3</sup>, ku vihet në pah domosdoshmëria e përmirësimit të standardeve gazetareske dhe e transparencës së mediave. Raporti i vitit 2023 vë në dukje nevojën për një transparencë më të madhe në lidhje me reklamën e institucioneve shtetërore dhe partive politike në media<sup>4</sup>.

<sup>3</sup> European Union, 2022. *North Macedonia Report 2022*. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/48ba61f0-41ae-4cff-9517-29fac190f4bd\\_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202022.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/48ba61f0-41ae-4cff-9517-29fac190f4bd_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202022.pdf) Qasje prej dt. 18.10.2023

<sup>4</sup> European Commission, 2023. *North Macedonia 2023 Report*. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_693%20North%20Macedonia%20Report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20Report.pdf) Qasje prej dt. 04.11.2023.



# Metodologjia

Për përpilimin e këtij dokumenti është përdorur një metodologji cilësore hulumtuese, e cila përfshin intervista të thella gjysmë të strukturuar dhe diskutime në kuadër të fokus-grupeve. Në periudhën tetor - nëntor 2023, janë realizuar 27 intervista të thelluara gjysmë të strukturuar me palë të ndryshme, duke përfshirë përfaqësues të organizatave dhe shoqatave mediatike dhe gazetareske, ekspertë të mediave, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në afirmimin e të drejtave të njeriut dhe autoritete rregullatore. Pjesëmarrësit u zgjodhën në bazë të përfshirjes dhe njohurive të tyre për sektorin e mediave në vend.

Gjithashtu, u zhvillua edhe një grup-fokus me koordinatorët lokalë të Shoqatës së Gazetarëve që përfaqësojnë rajone të ndryshme të vendit, me qëllim të grumbullimit të njohurive të llojllojshme.

Në kuadër të këtij procesi, u përfshi edhe një analizë sekondare e dokumenteve dhe raporteve ekzistuese, të përzgjedhura me kujdes, për sa i përket rëndësisë së tyre për integritetin e mediave. Synimi ishte plotësimi i të dhënave parësore me perspektiva më të gjera për situatën dhe sfidat rreth integritetit të mediave në vend.

Në mbështetje të objektivit të vendosur për vlerësimin e integritetit të mediave, pyetjet e hulumtimit janë si vijojnë:

- ▶ Sa janë të lira mediat nga ndikimet e jashtme, duke përfshirë presionet nga qendrat politike dhe të biznesit të pushtetit?
- ▶ Cilat janë sfidat dhe kufizimet e vërejtura në ruajtjen e integritetit të mediave?
- ▶ Çfarë roli luajnë mediat në vend në luftën kundër korrupsionit dhe sa janë të angazhuara në mënyrë efikase për t'i integruar këto angazhime në funksionimin e tyre?
- ▶ Në kontekstin e ndikimit të shtuar të mediave online, çfarë ndryshimesh janë të domosdoshme në mjedisin mediatik për t'u mbrojtur integriteti i mediave?

KJO QASJE SYNON TË NXJERRË NË  
PAH FUSHAT KRITIKE PËR VEPRIM NË  
NDËRTIMIN DHE RUAJTJEN E INTEGRITETIT  
TË MEDIAVE NË VEND.



## Integriteti mediatik: **ndikimet dhe sfidat**

**K**jo pjesë e Udhëzuesit thellohet në sfidat kryesore që lidhen me integritetin e mediave, si rezultat i një analize gjithëpërfshirëse të dokumenteve dhe raporteve të ndryshme relevante. Ndër të tjera, ato përfshijnë Raportet e Progresit të vendeve të Komisionit Europian, rekomandimet e Këshillit të Europës, vlerësimet e Freedom House dhe raportet e Reporterëve pa Kufij. Vështrimet nga kjo analizë ofrojnë një perceptim bazë për sfidat

sistemike dhe strukturore me të cilat përballet sektori i mediave. Gjetjet e marra do të plotësohen dhe kontekstualizohen nga analiza e mëvonshme e rezultateve të intervistave, që do të mundësojë një kuptim më të detajuar të sfidave në lidhje me integritetin e mediave dhe implikimet e tyre në realitetin e funksionimit të mediave.

## Interesat e politikës dhe biznesit ndikojnë në integritetin e mediave

Në vitin 2022, vendi ynë filloi procesin e reformave në sektorin e mediave, të orientuara në harmonizimin me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediatike Audiovizuale dhe standardet më të gjera të BE-së dhe Këshillit të Europës. Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve të dukshme në lirinë e mediave që nga viti 2017, ky sektor mbetet i ndikuar shumë nga politika dhe biznesi - gjë që ndikon në pavarësinë dhe lirinë e shprehjes<sup>5</sup>.

Në Monitorin e Pluralizmit Mediatik (MPM) të vitit 2023<sup>6</sup> theksohet nevoja urgjente për të shfuqizuar klientelizmin, i cili e pengon pavarësinë e mediave. Gjithashtu, MPM-ja drejton vëmendjen tek roli kryesor i

masave kundër korrupsionit në hulumtimin e lidhjes ndërmjet subjekteve politike dhe pronësisë së mediave. Kjo ndërlidhje është thelbësore për të kuptuar kapacitetin e mediave për t'i shërbyer në mënyrë të pavarur interesit publik.

Analiza e Fondacionit Metamorfozis<sup>7</sup> nxjerr në pah një tendencë shqetësuese, sipas së cilës lidhja mes politikës dhe mediave kontribuon ndjeshëm në përhapjen e dezinformatave, duke lënë në hije rolin e mediave si mbrojtëse e interesit publik. Mediat me orientime të ngjashme ideologjike-politike publikojnë informacione dhe dezinformata në mënyrë të koordinuar, ndërsa kjo praktikë e ndërlikon më tej luftën kundër dezinformatave dhe i thekson problemet në ruajtjen e një diskursi publik të balancuar<sup>8</sup>.

5 Freedom House, 2023. *North Macedonia: Nations in Transit 2023*. [online] Në dispozicion në: <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/nations-transit/2023>. Qasje prej dt. 17.10.2023.

6 Centre for Media Pluralism and Media Freedom, 2023. *Media Pluralism Monitor 2023*. [online] European University Institute. Në dispozicion në: <https://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor-2023/> Qasje prej dt. 01.11.2023

7 Stojanovski, F. (ed.) 2022. *Research: The Effects of Disinformation and Foreign Influences on the Democratic Processes in North Macedonia*. Skopje: Metamorphosis Foundation. Në dispozicion në: <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/themes/metamorphosis/download.php?id=34783> Qasje prej dt. 14.10.2023

8 Nehring, C. (ed.) 2023. *Blurring the Truth: Disinformation in South East Europe*. [online] Në dispozicion në: <https://www.kas.de/documents/281902/281951/E->

## Rreziqet nga reklamata shtetërore dhe politike

Ndikimi i reklamave shtetërore dhe politike në sektorin e mediave në vend është objekt i debatit dhe analizave të gjera publike. Derisa liria e përgjithshme e mediave shënon përmirësime, ndikimi i interesave politike dhe të biznesit vazhdon, duke i mjegulluar shpesh linjat midis gazetarisë së pavarur dhe agjendave të qendrave të fuqishme. Komuniteti i ekspertëve dhe sektori civil vazhdimisht e theksojnë nevojën e vendosjes së rregullave të rrepta dhe të qarta për reklama politike në legjisllacion dhe, veçanërisht, për reklamata shtetërore, sepse e kërcënon seriozisht pozitën e pavarur të mediave<sup>9</sup>.

Reformat e vitit 2017, që synonin heqjen e reklamave shtetërore në media, shënuan një ndryshim

book+Blurring+the+Truth.pdf/fd6abb3-f49e-115b-090e-7c9f3a20dfc6?version=1.2 &t=1680504776349 Qasje prej dt. 02.11.2023

9 S. Trpevska & I. Micevski, Media Sector Hotspots in North Macedonia: Decisive Reforms Long Overdue, ASPEN Institute Germany, December 2021, p.32. Available at: [https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021\\_Aspen-Germany\\_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf](https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021_Aspen-Germany_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf)

të rëndësishëm në politikën mediatike. Vendimi për heqjen e këtij lloji të reklamës<sup>10</sup> u mor menjëherë pas ardhjes në pushtet të garniturës së re politike në vitin 2017. Në të kaluarën, reklamata shtetërore, sipas vlerësimeve, ishin një nga mjetet më të fuqishme të përdorura për të kontrolluar mediat. Me këtë, pushteti e blinte favorin e mediave, që i shfrytëzonte si platforma për plasim agresiv të propagandës së saj politike<sup>11</sup>. Fonde të konsiderueshme u ndanë për fushata të vazhdueshme për çështje të ndryshme sociale dhe politike.

Megjithatë, pavarësisht heqjes së reklamave shtetërore, me ndryshimet shpesh në Kodin Zgjedhor, të miratuara në vitin 2018, partitë politike kanë futur një mekanizëm tjetër që i bën

10 Informacioni është në dispozicion në ueb faqen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. <https://vlada.mk/node/13272>

11 Nastoski, Zh. 2023. Reklamata shtetërore në media sjellin dëme të drejtpërdrejta dhe të pariparueshme. *Samoprasaj.mk*. [online] Në dispozicion në: <https://samoprasaj.mk/naacik/drzavnite-reklami-vo-mediumite-nosat-direktna-i-nepopravliiva-steta/> Qasje prej dt. 24.11.202.

mediat private të varura nga qendrat e fuqishme politike<sup>12</sup>. Në përputhje me nenin 76d të Kodit Zgjedhor<sup>13</sup>, gjatë një fushate zgjedhore reklama e partive politike në media mbulohet nga mjettet e buxhetit të shtetit.

Disa vite pas heqjes së reklamave shtetërore, ndodhi një kthesë tjetër. Qeveria aktuale propozoi rikthimin e reklamave shtetërore, përkatësisht ndryshimin e nenit 102 të Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale. Për Asociacionin e Mediave të televizioneve nacionale terestriale (AMM), kjo iniciativë e Qeverisë është plotësisht e justifikuar<sup>14</sup>. Ky

ndryshim i madh i politikës u justifikua edhe nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), duke konsideruar se në këtë mënyrë sigurohet një shpëtim ekonomik që është jetike për mediat të cilat janë duke luftuar gjatë kësaj kohe pasigurie<sup>15</sup>.

Por kjo lëvizje u prit me një dënim të ashpër nga shoqatat e gazetarëve dhe të mediave, si dhe nga komuniteti i ekspertëve<sup>16</sup>. Kjo, sipas tyre, i shndërron mediat private në institucione partiake-ideologjike të cilat, në fund të fundit, i mbrojnë interesat komerciale të pronarëve në kurriz të interesit publik<sup>17</sup>. Duke marrë parasysh

12 Trpevska, S. and Micevski, I., 2021. Media Sector Hotspots in North Macedonia: Decisive Reforms Long Overdue. In: *Aspen Institute Germany*. December 2021, p.32. Në dispozicion në: [https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021\\_Aspen-Germany\\_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf](https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021_Aspen-Germany_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf) Qasje prej dt. 21.10.2023.

13 Ligji është në dispozicion në: [https://dzt.mk/sites/default/files/2021-10/izboren\\_zakonik\\_precisten\\_tekst\\_0.pdf](https://dzt.mk/sites/default/files/2021-10/izboren_zakonik_precisten_tekst_0.pdf)

14 Aleksandar Atanasov, 2021. MMA: Qeveria të përgatitë propozim-ndryshim të nenit 102 të Ligjit për Media dhe ta dorëzojë në Kuvend. *Agjenci informative mediatike*. [online] <http://bit.ly/4leidhE> Qasje prej dt. 02.11.2023

15 International Press Institute, 2023. *Policy Paper: Support for Public Interest Journalism in North Macedonia*. Në dispozicion në: <https://ipi.media/policy-paper-support-for-public-interest-journalism-in-north-macedonia/> Qasje prej dt. 15.10.2023

16 SHGM së bashku me SPGPM, KEMM,RQM, IMM,ISK dhe RESIS paralajmëruan se rikthimi i reklamave shtetërore në media mund të ndikojë në politikën redaktuese, siç ishte në të kaluarën.

17 Trpevska, S. and Micevski, I., 2021. Media Sector Hotspots in North Macedonia: Decisive Reforms Long Overdue. In: *Aspen Institute Germany*. December 2021, p.32. Në

rrezikun e cenimit të pavarësisë redaktuese, shoqatat gazetareske dhe mediatike ofruan një zgjidhje tjetër, respektivisht përdorimin e fondeve shtetërore për të përfunduar pluralizmin mediatik dhe për të përmirësuar cilësinë e gazetarisë. “Qëndrimi ynë është se paratë shtetërore mund të përdoren në media, por për prodhimeve cilësore, për pluralizëm mediatik, që do të ngritë cilësinë e gazetarisë dhe të mediave në tërësi. Nuk duket kështu me ligjin e propozuar”<sup>18</sup>.

dispozicion në: [https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021\\_Aspen-Germany\\_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf](https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021_Aspen-Germany_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf) Qasje prej dt. 21.10.2023.

18 Stojançova, P., 2023. Parti të bashkuara kthejnë reklamat qeveritare. *Radio Europa e Lirë*, 16 nëntor 2023. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/slozhni-partii-vladini-reklami-vrakjaat/32687388.html> Qasje prej dt. 08.10.2023.

Lidhur me nevojën për të adresuar shqetësimet që kanë të bëjnë me reklamat politike shtetërore në përputhje me praktikat më të mira europiane, parimet e përshkruara në Aktin European për Lirinë e Mediave janë veçanërisht të rëndësishme<sup>19</sup>. Në të theksohet nevoja për kritere transparente dhe të paanshme në shpërndarjen e mjeteve për mediat, të harmonizuara me standardet europiane. Le të kujtojmë se e njëjta është e përfshirë në të ashtuquajturat **Prioritete të reformës urgjente** të Grupit të ekspertëve Reinhard Priebe<sup>20</sup> të harmonizuara në vitin 2025. Në Strategjinë Kombëtare

19 European Parliament, 2023. *European Media Freedom Act*. Në dispozicion në: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0336\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0336_EN.pdf) Qasje prej dt. 02.11.2023.

20 European Commission (Komisioni European), 2015. Prioritetet urgjente të reformave për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Urgent Reform Priorities for the Former Yugoslav Republic of Macedonia). Në dispozicion në: [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent\\_reform\\_priorities\\_mk.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf) Qasje prej dt. 18.11.2023

për Parandalimin e Korrupsionit, në të cilën renditen problemet prioritare që gjenerojnë rrezik të lartë korrupsioni, vihet në dukje se për përmirësimin e situatës në sferën e mediave dhe për parandalimin e abuzimeve për qëllime politike, është e nevojshme të forcohet mbikëqyrja dhe të hiqen reklamat e paguara politike të partive në ciklet zgjedhore<sup>21</sup>.

Edhe Shoqata e Mediave Online (Onlinemedia.mk) reagon ndaj ndryshimeve të propozuara ligjore për reklamat shtetërore, sipas të cilave ofrojnë mbështetje financiare selektive për mediat tradicionale, që konsiderohet si padrejtësi ndaj mediave në internet. Sipas Shoqatës, çdo shpërndarje e mjeteve publike për mediat duhet të jetë racionale, gjithëpërfshirëse, jodiskriminuese, e qëndrueshme dhe, në radhë të parë, të synojë

mbështetjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë e jo pronarëve të mediave<sup>22</sup>.

Megjithatë, ndryshe nga debati rreth reklamave shtetërore në mediat radiodifuzive, Qeveria ka një qasje të ndryshme ndaj mediave të shkruara. Për të adresuar presionin financiar, të shkaktuar nga ndalimi i reklamave, në vitin 2018 u vendos një program për të subvencionuar shpenzimet e shtypjes së gazetave. Kjo nismë, e ndryshme nga reklamat shtetërore dhe e zakonshme në shumë shtete, është një formë e mbështetjes shtetërore që ka ardhur si rezultat i lobimit nga industria e mediave të shkruara. Monitori i Pluralizmit Mediatik MPM) në raportin e vitit 2022 e përshkruan rrezikun e këtij financimi si minimal, në krahasim me ndërhyrjet e mundshme në politikën redaktuese<sup>23</sup>.

21 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 2021. Strategjia Kombëtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Në dispozicion në: <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategjia-DKSK-KONECNA.pdf> Qasje prej dt. 14.11.2023.

22 AION, 2023. Shoqata Onlinemedia: Të hiqet kufizimi për financimin zgjedhor të portaleve të internetit. 9 nëntor 2023. Në dispozicion: <https://aion.mk/macedonia/zdruzenie-onlajnmedia-da-se-ukine-ogranichuvanieto-za-izborna-finansiranje-na-internet-portalite/> Qasje prej dt. 17.11.2023.

23 Centre for Media Pluralism and Media Freedom, 2023. Media Pluralism Monitor



Deri në finalizimin e këtij Raporti, legjislatiioni është ende i pandryshuar, por një propozim-ligj që do të hiqte ndalimin e reklamave qeveritare në mediat private është në procedurë parlamentare.

Në fokusin e diskutimeve aktuale mbetet çështja se si të arrihet ekuilibri midis ofrimit të mbështetjes së domosdoshme për mediat dhe ruajtjes së pavarësisë së tyre nga ndikimet politike.



## **Propozimi për qëndrueshmëri më të madhe të sektorit të mediave: fond për zhvillimin e mediave**

Krijimi i një Fondi për zhvillimin e mediave është një temë që është diskutuar prej kohësh në vend, veçanërisht në mesin e shoqatave kryesore të gazetarëve. Ky propozim konsiderohet si një mekanizëm për të inkurajuar një gazetari të larmishme dhe me cilësi të lartë që do t'i shërbejë interesit publik. Modeli i fondit parashikon një sistem, ku sektorë të ndryshëm mediatikë,

përfshirë mediat jofitimprurëse, private, radiodifuzive, të shkruara dhe ato online, do të mund të kërkojnë mbështetje financiare për projekte gazetareske. Qëllimi është të përforcohet kjo industri, duke siguruar që përmbajtja e prodhuar do të jetë me interes publik dhe prej së cilës do të ketë dobi e tërë shoqëria, duke përfshirë komunitetet pakicë<sup>24</sup>.

<sup>24</sup> International Press Institute, 2023. Policy Paper: Support for Public Interest Journalism in North Macedonia. [online] Në dispozicion në: <https://ipi.media/policy-paper-support-for-public-interest-journalism-in-north-macedonia/> Qasje prej dt. 15.10.2023

Në dokumentin e politikave publike, të përpiluar nga Instituti Ndërkombëtar i Shtypit (IPI), si pjesë e raportit të publikuar, pas misionit ndërkombëtar për vlerësimin e gjendjes së lirisë së mediave në Maqedoninë e Veriut<sup>25</sup>, rekomandohen zgjidhje që mbështesin zhvillimin ekonomik të mediave, duke i dhënë prioritet gazetarisë me interes publik. Këto rekomandime synojnë një fond të pluralizmit mediatic që do të koordinohet nga një autoritet pavarur. Ky Autoritet, i përbërë nga ekspertë relevantë mediaticë, duke përfshirë palët e interesuara nga shoqatat e mediave, OJQ-të, komunitetin akademik dhe organizatat kulturore, do të vlerësojë aplikimet e projekteve dhe do të marrë vendim për ndarjen e mjeteve për projekte.<sup>26</sup>

25 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, 2023. *Fact-Finding PFM Report*. Në dispozicion në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/10/EN-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web.pdf> Qasje prej dt. 18.11.2023.

26 Ibid.

Në Rezolutën 1636 (2008)<sup>27</sup> të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, u bëhet thirrje shteteve të ndërmarrin hapa për të inkurajuar pluralizmin mediatic, duke theksuar se liria e mediave në një demokraci kërkon subvencione të drejta dhe neutrale shtetërore për mediat. Edhe në Rekomandimin nr. R (99) të Komitetit të Ministrave inkurajohet mundësia e futjes së skemave të mbështetjes financiare të drejtpërdrejta ose indirekte për mediat e shkruara dhe radiodifuzive, veçanërisht në nivel rajonal dhe vendor, si dhe shqyrtimin e mundësisë për subvencionimin e subjekteve mediatike që shtypin ose transmetojnë në ndonjë nga gjuhët e pakicave<sup>28</sup>.

Në të njëjtën kohë po zhvillohen diskutime edhe për nevojën për financim të qëndrueshëm të

27 Parliamentary Assembly of the Council of Europe, 2008. *Resolution 1636 (2008)* [online] Në dispozicion në: <https://assembly.coe.int/nw/xml/xref/xref-xml2html-en.asp?fileid=17684&lang=en>

28 Committee of Ministers of the Council of Europe, 1999. *Recommendation No. R (99) 1 on Measures to Promote Media Pluralism*. [online] Në dispozicion në: <https://rm.coe.int/16804fa377> Qasje prej dt. 01.11.2023.

shërbimit radiodifuziv publik. Në Raportin e BE-së mbi progresin e vendit, theksohet po ashtu nevoja kritike për financim konsekuent dhe adekuat të shërbimit radiodifuziv publik, duke e identifikuar si një gur themeltar të qëndrueshmërisë dhe integritetit mediatic në vend. Pavarësisht Ligjit të Shërbimeve Mediatiche Audio dhe Audiovizuele të vitit 2021, në vitin 2022 autoritetet i shfrytëzuan edhe një herë kompetencat diskrecionale, të dhëna me ligj, për të reduktuar financimin e sektorit radiodifuziv. Sipas Raportit të EK-së<sup>29</sup>, luhatjet buxhetore krijojnë pasiguri në planifikim. Autoritetet duhet të sigurojnë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për shërbimin radiodifuziv.

Në të njëjtën kohë, theksohet edhe rëndësia e mbështetjes së mediave të komuniteteve, si një nxitje alternative për demokracinë pluraliste

29 European Commission, 2023. *North Macedonia 2023 Report*. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_693%20North%20Macedonia%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf) Qasje prej dt. 04.11.2023.

lokale. Përvojat e vendeve të tjera tregojnë se mediat e komuniteteve kontribuojnë në diversitetin e të gjithë peizazhit mediatic, por edhe për inkurajimin e qytetarisë aktive dhe demokracisë pluraliste, veçanërisht në nivel lokal<sup>30</sup>. Këto media nuk identifikohen në politikat dhe në legjislacion, ndaj nuk kanë as mbështetje sistematike as financiare nga shteti. Rekomandimet e Këshillit të Europës<sup>31</sup> dhe UNESCO<sup>32</sup> i referohen mbështetjes së këtij lloji të mediave.

30 RESIS, 2023. *Media e komunitetit – nxitje alternative për demokracinë pluraliste lokale*. Në dispozicion në: [https://resis.mk/images/abut-us/PDF/001com\\_media\\_policy\\_brief.pdf](https://resis.mk/images/abut-us/PDF/001com_media_policy_brief.pdf) Qasje prej dt. 12.11.2023

31 Committee of Ministers of the Council of Europe, 2018. *Recommendation CM/Rec(2018)1 on Media Pluralism and Transparency of Media Ownership*. [online] Në dispozicion në: [https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset\\_publisher/aDXmrol0vwsU/content/recommendation-cm-rec-2018-1-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-media-pluralism-and-transparency-of-media-ownership](https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vwsU/content/recommendation-cm-rec-2018-1-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-media-pluralism-and-transparency-of-media-ownership) Qasje prej dt. 01.12.2023

32 UNESCO, 2017. *Providing Public Funding for Community Broadcasting*. *Community Media Sustainability Policy Series*, 5. [online] Në dispozicion në: [https://en.unesco.org/sites/default/files/unesco\\_cmedia\\_sustainability\\_policy\\_5\\_public\\_funding.pdf](https://en.unesco.org/sites/default/files/unesco_cmedia_sustainability_policy_5_public_funding.pdf) Qasje prej dt. 11.11.2023

## Barrierat socio-ekonomike e rrënojnë integritetin e mediave në Maqedoninë e Veriut

Statusi socio-ekonomik i gazetarëve në vend ndikon drejtpërdrejt në integritetin e mediave. Në qershor të vitit 2023, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) organizoi një mision ndërkombëtar për konstatimin e fakteve<sup>33</sup> për të hetuar sfidat aktuale në sektorin e mediave. Gjetjet tregojnë se shumë gazetarë ballafaqohen me kushte të këqija të punës, jo vetëm për sa i përket pagave joadekuate dhe statusit të pasigurt të punësimit, por edhe për sa i përket respektimit të të drejtave të tyre të punës<sup>34</sup>.

33 Përbëhej nga përfaqësues të Qendrës Europiane për Lirinë e Shtypit dhe Mediave (ECPMF), Federatës Europiane të Gazetarëve (EFJ), Free Press Unlimited (FPU), Institutit Ndërkombëtar të Mediave (IPI) dhe Osservatorio Balcani e Caucaso Transeuropa (OBCT).

34 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, 2023. Liria e mediave në Maqedoninë e Veriut: progresi në këmbë të qelqta. Në dispozicion në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/10/EN-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web.pdf> Qasje prej dt. 05.11.2023

Kushtet e këqija të punës, të cilat karakterizohen me paga të ulëta dhe pasiguri në punë, ndikojnë jo vetëm në statusin e gazetarëve, por edhe në aftësinë e tyre për të punuar në mënyrë të pavarur. Ndër sfidat sistematike që duhet të adresohen, Raporti i KE-së vë në dukje kushtet e punës për punonjësit e mediave, veçanërisht të drejtat e tyre sociale dhe të punës<sup>35</sup>.

Përveç kësaj, sipas Indeksit të sivjetshëm Botëror të Lirisë së Shtypit<sup>36</sup>, gazetarët janë vazhdimisht në shënjestër të sulmeve verbale. Nën pretekstin e mbrojtjes së sekreteve shtetërore dhe të të dhënave personale, ata mund të ekspozohen ndaj presionit ligjor dhe ndjekjes (SLAPP ose padi strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut). Edhe në Raportin e BE-së të vitit të kaluar mbi progresin e vendit,

35 European Commission, 2023. *North Macedonia 2023 Report*. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_693%20North%20Macedonia%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf) Qasje prej dt. 04.11.2023.

36 Reporters Without Borders (RSF), North Macedonia. [online] Në dispozicion në: <https://rsf.org/en/country/north-macedonia> Qasje prej dt. 02.11.2023

theksohet problemi me kushtet e pavoritshme të punës. E gjithë kjo ndikon në cilësinë e punës së gazetarëve dhe, shpeshherë, ata vendosin të largohen nga profesioni.

Sipas Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve të Maqedonisë, faktorët që kontribuojnë që gazetarët të mendojnë për të lënë profesionin janë pagat e ulëta, presioni i lartë në vendin e punës, pritshmëritë e redaksisë dhe audiencës dhe dëshira për një karrierë alternative, veçanërisht në marrëdhëniet me publikun<sup>37</sup>.

Këto sfida socio-ekonomike, jo vetëm që e reduktojnë rolin e mediave si mbrojtëse të interesit publik, por e rrënojnë edhe besimin e publikut në përmbajtjet gazetareske. Për të zgjidhur këto çështje, ka nevojë për korniza të forta ligjore që i mbrojnë të drejtat e gazetarëve, së bashku me iniciativat për përmirësimin e kushteve të punës dhe pagave të tyre. Masat e këtilla janë thelbësore për ruajtjen e integritetit mediatik.

<sup>37</sup> Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë (SPGPM), Përse ikin gazetarët nga profesioni. [online] Në dispozicion në: <https://bit.ly/3I5aZWW>

## Mediat online dhe mungesa e masave përkatëse rregullatore

Akti për lirinë e mediave<sup>38</sup> e thekson nevojën për rregulla të harmonizuara për të mbrojtur pavarësinë e të gjitha llojeve të mediave – online dhe offline. Mungesa e transparencës në strukturat pronësore dhe financiare është një problem i veçantë me platformat e mediave online, ku disa prej tyre, madje, imitojnë mediat ekzistuese për të përhapur lajme të rreme<sup>39</sup>.

Prandaj, në kontekstin e sfidave rregullatore me të cilat përballet sektori i mediave online në Maqedoninë e Veriut, Rekomandimi i Komisionit

38 European Parliament, 2023. European Media Freedom Act. Në dispozicion në: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0336\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0336_EN.pdf) Qasje prej dt. 02.11.2023.

39 Trpevska, S. and Micevski, I., 2021. Media Sector Hotspots in North Macedonia: Decisive Reforms Long Overdue. In: Aspen Institute Germany. December 2021, p.32. Në dispozicion në: [https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021\\_Aspen-Germany\\_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf](https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021_Aspen-Germany_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf) Qasje prej dt. 21.10.2023

European për masat mbrojtëse të brendshme për pavarësinë redaktuese dhe transparencën e pronësisë në sektorin e mediave bëhet shumë i rëndësishëm<sup>40</sup>. Ky rekomandim, (BE) 2022/1634, i inkurajon shtetet-anëtare të zbatojnë masa që promovojnë pluralizmin mediatik dhe transparencën në pronësinë e mediave. Në të referohet nevoja për të krijuar një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse për pronësinë e mediave në internet, nën juridiksionin dhe menaxhimin e një Autoriteti rregullator kombëtar. Kjo bazë e të dhënave do të ofrojë informacione të detajuara dhe lehtësisht të aksesueshme mbi pronësinë e mediave, duke përfshirë mediat rajonale dhe lokale dhe, në këtë mënyrë, do të rritet transparenca dhe aksesimi i publikut në të dhënat mbi pronësinë e tyre. Të

40 European Union, 2022. Commission Recommendation of 14.9.2022 on the protection, safety and empowerment of journalists and other media professionals (2022/C 346/01). *EUR-Lex*. [online] Në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32022H1634> Qasje prej dt. 14.11.2023.

gjitha mediat do të detyrohen ligjërisht të publikojnë të dhëna për strukturën e pronësisë dhe të garantojnë pavarësinë e redaktorëve. “Ne kemi dispozita të tilla në ligjet tona për mediat, por do të duhet t’i saktësojmë, t’i plotësojmë dhe t’i zbatojmë në mediat online, të cilat aktualisht nuk janë objekt i rregullimit ligjor”<sup>41</sup>.

Ekspansioni i mediave online dhe përdorimi masiv i rrjeteve sociale ka rritur hapësirën për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformatave. Studimi “Baza politike dhe ekonomike e mediave dhe modeleve të komunikimit që përhapin dezinformata dhe gjuhë të urrejtjes”<sup>42</sup> vëren se dezinformimi

në vend gjatë viteve 2019-2020 ishte më i pranishëm në mediat online dhe rrjetet sociale. Këtë e konfirmojnë edhe pasqyrat statistikore të punës së Komisionit për ankesa pranë Këshillit për Etikë në Media të Maqedonisë (KEMM), sipas të cilit mediat online në vitet e fundit janë shkelësit më të shpeshtë të standardeve për informim profesional<sup>43</sup>.

Për të vendosur rend në sferën e gazetarisë online, në vitin 2019 u krijua Regjistri i Mediave Profesionale Online – iniciativë kjo e Shoqatës së Gazetarëve dhe Këshillit për Etikë në Media. Kjo iniciativë, sipas së cilës mediat që duan të jenë anëtare të Autoritetit vetërregullues

41 Vasilevska, M. 2023. *Dr. Tërpevska: Akti i ri i BE-së duhet të rregullojë edhe marrëdhëniet ndërmjet mediave dhe platformave digjitale dhe rrjeteve sociale që kanë marrë rolin e rojtarëve*, 18 shkurt, 2023, në dispozicion në: <https://racin.mk/intervju/d-r-trpevska-noviot-akt-na-eu-treba-da-gi-uredi-i-odnosite-megu-mediumite-i-digitalnite-platформи-i-socizjalni-mrezhi-koi-si-ja-prezedo-a-ologata-na-gejtkiperi/>

42 Nikodinoska, V. 2020. *Baza politike dhe ekonomike e mediave dhe modeleve të*

*komunikimit që përhapin dezinformata dhe gjuhë të urrejtjes*. Instituti Maqedonas për Media. Në dispozicion në: <https://mim.org.mk/attachments/article/1230/Mediumski%20i%20komunikaciski%20modeli%20koi%20shirat%20dezinformacii%20i%20govor%20na%20omraza.pdf> Qasje prej dt. 01.12.2023

43 Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni, *Komisioni i ankesave: pasqyrë statistikore*, në dispozicion në: <https://www.semm.mk/komisija-za-zhalbi/statistichki-pregledi> Qasje prej dt. 08.11.2023



duhet të respektojnë kriteret dhe rregulla të caktuara<sup>44</sup>, ka hasur në jehonë edhe pozitive nga Federata Europiane e Gazetarëve<sup>45</sup>.

Megjithatë, mbetet e pashmangshme nevoja për të harmonizuar legjislacionin me standardet e BE-së. Në Raportin e Komisionit European nga procesi i skringut, i publikuar në qershor, theksohet kjo urgjencë, si dhe kërkesa që Maqedonia e Veriut të harmonizojë ligjet e saj me të drejtën e BE-së për të luftuar në mënyrë efektive kërcënimet në rritje të dezinformimit, veçanërisht nga burimet online<sup>46</sup>.

44 Këshilli për Etikë në Media, Rregullat e anëtarësimit. Në dispozicion në: <https://www.semml.mk/chlenstvo/pravila-za-chlenstvo>

45 European Federation of Journalists (EFJ), 2019. *North Macedonia: EFJ welcomes initiative aiming to strengthen self-regulation*. [online] 19 December 2019. Në dispozicion në: <https://europeanjournalists.org/blog/2019/12/19/north-macedonia-efj-welcomes-initiative-aiming-to-strengthen-self-regulation/> Qasje prej dt. 15.11.2023.

46 European Commission, Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations, 2023. *MK Cluster 1 Draft Screening Report*. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/MK%20Cluster\\_1%20Draft%20screening%20report\\_external%20version](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/MK%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version).

## (Jo)profesionalizmi në redaksi dhe roli i vetërregullimit mediatik

Respektimi i standardeve profesionale në redaksi është me rëndësi të jashtëzakonshme për ruajtjen e besimit të publikut dhe integritetit të mediave. Raportet e organizatave ndërkombëtare tregojnë për probleme të theksuara në këtë drejtim.

Raporti i Freedom House për vitin 2022<sup>47</sup> paraqet një pamje shqetësuese të ambientit mediatik të vendit, i cili thotë se ky ambient karakterizohet nga keqinformimi i përhapur dhe nga mungesa e theksuar e profesionalizmit. Kjo pasohet nga Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit nga viti 2023<sup>48</sup>. Pavarësisht se vendi renditet në vendin e 57-të në Indeks, me një përmirësim

pdf Qasje prej dt. 17.11.2023.

47 Freedom House, 2022. *North Macedonia: Freedom in the World 2022 Report*. Në dispozicion në: <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/freedom-world/2022> Qasje prej dt. 02.11.2023.

48 Reporters Without Borders (RSF), North Macedonia. Në dispozicion në: <https://rsf.org/en/country/north-macedonia> Qasje prej dt. 02.11.2023

prej 33 vendesh në krahasim me vitin 2021, sërish vërehet se përhapja e dezinformatave dhe mungesa e profesionalizmit kontribuojnë në rënien e besimit të shoqërisë ndaj mediave - gjë që i ekspozon mediat e pavarura ndaj kërcënimeve dhe sulmeve.

Nga ana tjetër, pavarësisht se Shërbimi i transmetimit publik tregon shenja progresi drejt pavarësisë funksionale dhe profesionalizmit, i njëjti ende po përballet me sfida thelbësore. Këto përfshijnë kufizimet e vazhdueshme financiare, çështjet e personelit e tjerë.<sup>49</sup>

49 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, 2023. Liria e mediave në Maqedoninë e Veriut: progresi në këmbë të qelqta. Në dispozicion në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/10/EN-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web.pdf> Qasje prej dt. 05.11.2023

Një aspekt shpeshherë i anashkaluar, por thelbësor i pluralizmit mediatik, është aksesit i grupeve të ndryshme shoqërore dhe komuniteteve lokale në platformat mediatike dhe sferën publike në tërësi.<sup>50</sup>

Për të përballuar këto sfida, ekziston një nevojë urgjente për të përforcuar mekanizmat e vetërregullimit në redaksitë, duke siguruar respektim të rreptë të standardeve profesionale dhe praktikave etike gazetareske. Në këtë drejtim, roli i Këshillit për Etikë në Media – Autoritet vetërregullues që i trajton ankesat në lidhje me shkeljet e kornizës etike, bëhet vendimtar. Në vitin 2022, një pjesë e konsiderueshme e vendimeve të Këshillit (49,37%) u janë referuar shkeljeve në lidhje me saktësinë

50 Esch, V. and Palm, V., 2021. *Media Freedom in the Western Balkans*. Aspen Institute Germany. Në dispozicion në: [https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021\\_Aspen-Germany\\_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf](https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021_Aspen-Germany_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf) Qasje prej dt. 19.11.2023.

dhe verifikimin e informacioneve. Megjithatë, në punën e këtij Autoriteti ka pasur presione nga subjektet politike, ekonomike dhe mediatike<sup>51</sup>.

Nevoja për përforcimin e vetërregullimit është theksuar edhe në Raportin e KE-së për progresin e shtetit<sup>52</sup>. Në këtë drejtim, shoqatat mediatike vazhduan të promovojnë Regjistrin e krijuar të mediave profesionale online (promedia.mk) me qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe standardeve në gazetarinë online. Nevoja për të përforcuar vetërregullimin në mediat online theksohet edhe

51 European Commission, 2023. North Macedonia 2023 Report. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023/11/SWD\\_2023\\_693%20North%20Macedonia%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023/11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf) Qasje prej dt. 04.11.2023.

52 European Commission, 2022. North Macedonia Report 2022. [online] Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/48ba61f0-41ae-4cff-9517-29fac190f4bd\\_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202022.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/48ba61f0-41ae-4cff-9517-29fac190f4bd_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202022.pdf)

në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit<sup>53</sup>. Ndërkohë, Këshilli për Etikë në Media tashmë përgatiti Udhëzime për raportim etik në mediat online<sup>54</sup>. Ndonëse kanë kaluar vetëm dy vjet nga miratimi i këtij dokumenti, ekspertët vënë në dukje për nevojën e përditësimit të tij. Komisioni i Ankesave pranë KEMM-it vë në dukje disa sfida që lidhen, para së gjithash, me punën e mediave online, si p.sh., në lidhje me çështjen e përgjegjësisë për tekstet dhe komentet e lexuesve në rrjetet

53 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 2021. Strategjia Kombëtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Në dispozicion në: <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategjia-DKSK-KONECNA.pdf> Qasje prej dt. 14.11.2023.

54 Këshilli për Etikë në Media, Udhëzime për raportim etik të mediave online. Në dispozicion në: <https://semm.mk/dokumenti/korisni-resursi/kodeks/850-nasoki-za-etichko-izvestuvanje-na-onlajn-mediumite> Qasje prej dt. 01.12.2023.

sociale<sup>55</sup>. Këshilli i Nderit pranë SHGM-së është një tjetër autoritet vetërregullues, roli i të cilit është të kujdeset dhe të promovojë gazetarinë profesionale dhe të përgjegjshme dhe të reagojë kur gazetarët e shkelin Kodin. Në përgjithësi, shumicës së mediave u mungojnë mekanizmat e brendshëm për vetërregullim në organizatat individuale mediatike, siç janë ombudsmanët mediatikë ose kodet e brendshme të sjelljes etike.<sup>56</sup>

55 Tuneva, M., Nikodinovska, V., 2023. *Përforsimi i domosdoshëm i mekanizmave dhe avancimi i efikasitetit: Vetë-rregullimi i mediave në Maqedoninë e Veriut*. Instituti Maqedonas për Media.

56 Ibid

## xxBarazia gjinore në media – progresi dhe sfidat

Barazia gjinore në media është ka rëndësi thelbësore në lidhje me integritetin e mediave, që nënkupton përfaqësim dhe trajtim të drejtë të gjinisë në përmbajtjen dhe praktikën e punës mediatike. Është gjithashtu në përputhje me angazhimet në nivel global. Konventa e Stambollit i inkurajon mediat të inkorporojnë udhëzime dhe standarde vetërregulluese, me qëllim që të forcohet respekti për dinjitetin e grave dhe të kontribuojnë në parandalimin e dhunës ndaj tyre<sup>57</sup>. Këto standarde duhet të rezultojnë në shmangien nga stereotipat e dëmshëm gjinorë dhe nga përhapja e imazhit degradues për gruan. Njëkohësisht, është e rëndësishme që këto masa të

57 Council of Europe. Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention). Në dispozicion në: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/text-of-the-convention>. Qasje prej dt. 22.11.2023.

ndërmerren duke respektuar parimin bazë mbi të cilin bazohet funksionimi i mediave, që është liria e shprehjes, liria e mediave dhe liria e shprehjes artistike<sup>58</sup>. Barazia gjinore si një tregues kuptimplotë i integritetit të mediave është thelbësore dhe përputhet me përpjekjet globale, si Strategjia e UNDP-së për Barazi Gjinore 2022-2025<sup>59</sup>. Monitoruesi i Pluralizmit Mediatik (MPM) për vitin 2022 vë në dukje një rrezik mesatar prej 65% në lidhje me barazinë gjinore në mediat në vend. Megjithatë, në mediat private ka një përfaqësim jo të kënaqshëm të grave në role

58 Tuneva, M. and Boshkova, H., 2023. *Raportimi etik për dhunën me bazë gjinore në Maqedoninë e Veriut Res Publica*. Në dispozicion në: <https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2023/10/etichko-izvestuvanje-za-rodovo-baziranoto-nasilstvo-mk-1.pdf> Qasje prej dt. 09.11.2023.

59 United Nations Development Programme (UNDP), 2022. *The Gender Equality Strategy 2022-2025*. Në dispozicion në: <https://genderequalitystrategy.undp.org/#:~:text=The%20Gender%20Equality%20Strategy%202022%2D2025%20sets%20out%20an%20ambitious,rigid%20responses%20to%20gender%20equality> Qasje prej dt. 03.11.2023

ekzekutive, me më pak se 18%, ndërsa në pozitat redaktuese gratë përbëjnë rreth 39% në sektorin audio-vizual dhe 48% në radio<sup>60</sup>. Përveç kësaj, temat e barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore shpeshherë janë jashtë fokusit të raportimit mediatik<sup>61</sup>.

Prandaj, është imperativ që të forcohet barazia gjinore në sektorin mediatik, jo vetëm për harmonizimin me standardet ndërkombëtare, por edhe për të krijuar një ambient mediatik që përfaqëson dhe respekton në mënyrë autentike diversitetin e shoqërisë. Këtu përfshihen stacionet televizive private që duhet t'i përafrojnë programet

60 Centre for Media Pluralism and Media Freedom, 2023. *Media Pluralism Monitor 2023*. [online] European University Institute. Në dispozicion në: <https://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor-2023/> Qasje prej dt. 01.11.2023

61 Tuneva M. and Boshkova, N., 2023. *Raportimi etik për dhunën me bazë gjinore në Maqedoninë e Veriut Res Publica*. Në dispozicion në: <https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2023/10/etichko-izvestuvanje-za-rodovo-baziranoto-nasilstvo-mk-1.pdf> Qasje prej dt. 09.11.2023.

dhe përmbajtjet e tyre me standardet bashkëkohore të barazisë gjinore dhe të raportojnë në mënyrë të paanshme për çështjet gjinore<sup>62</sup>.

Krahas kësaj, autoritetet rregullatore, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat duhet të promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore dhe të përmirësojnë edukimin mediatik, pasi këto janë hapa kryesorë drejt një mjedisi mediatik më gjithëpërfshirës dhe më të drejtë. Në përputhje me këtë, Rregullatori tashmë po punon me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, duke u fokusuar në promovimin e edukimit

62 Micevski, I. 2019. Gjinia në media 2019: Analizë e aspekteve gjinore në programet për fëmijë në televizionet nacionale terestriale. Në dispozicion në: <https://resis.mk/attach/rodot-vo-mediumite-2020.pdf>

mediatik dhe në adresimin e çështjeve të të drejtave të njeriut, përfshirë këtu barazinë gjinore dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara nga radiodifuzerët<sup>63</sup>.

63 European Commission, 2023. North Macedonia 2023 Report. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_693%20North%20Macedonia%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf) Qasje prej dt. 04.11.2023.



## Gjetje nga intervistat dhe fokus-grupi

sfidat, zbrazëtirat dhe mundësitë për përmirësimin e integritetit mediatic

### Integriteti mediatic – çfarë nënkupton kjo?

Palët përkatëse e përkufizojnë integritetin mediatic si një koncept të shumë-shtresor, me rëndësi parësore për demokracinë në shoqëri. Integriteti mediatic mbulon jo vetëm pavarësinë e mediave në aspektin e lirisë së shprehjes, por edhe qëndrueshmërinë

ekonomike dhe transparencën e tyre. Integriteti është thelbësor për të fituar besimin e publikut dhe për të përmbushur rolin e mediave në shoqëri, por shpeshherë rrënohet nga korrupsioni ekonomik, politik dhe institucional.

Pjesëmarrësit e intervistuar në këtë Analizë theksojnë se integriteti mediatic nënkupton

t'i shërbesh interesit publik, por edhe rezistimin ndaj ndikimeve të panevojshme si presionet politike, klientelizmi dhe fuqia ekonomike. *“Nuk është fjala vetëm me raportimin e saktë dhe të drejtë, por edhe për kulturën që kultivon një etnitet mediatik, komunikimin e tij afarist dhe transparencën rreth pronësisë dhe proceseve redaktuese”.*

Një industri e fortë dhe e vetë-qëndrueshme mediatike konsiderohet thelbësore për arritjen e integritetit mediatik. Megjithatë, palët përkatëse vërejnë se një industri e tillë e fuqishme aktualisht mungon në vend. *“Integriteti i mediave varet edhe nga ndërgjegjësimi dhe veprimi i redaksive dhe strukturave drejtuese. Kjo përfshin përkushtimin për të qenë i besueshëm, profesional dhe i paanshëm”.*

Sfidat ekonomike, si pagat e ulëta dhe statusi i dobët socio-ekonomik i profesionistëve të mediave, shihen si një kërcënim i rëndësishëm për

integritetin e mediave. *“Këto situata shpeshherë çojnë në cenueshmëri ndaj presioneve të ndryshme, duke e rrezikuar integritetin gazetaresk. Kjo situatë rëndohet edhe më shumë për shkak të mungesës së pavarësisë financiare nga autoritetet shtetërore”.*

Palët e interesuara e theksojnë, gjithashtu, edhe rëndësinë e rolit të mediave në mbrojtjen e interesit publik dhe avokimin për të mirën publike. *“Integritetin e lidh në mënyrë të pandashme me dy terma të tjerë, që janë identiteti dhe imuniteti i medias. Dhe ato janë të ndërlidhura. Nëse një media nuk krijon identitet, vështirë se do të ruajë apo krijojë integritet. Kur i kombinon së bashku, është një bazë e mirë për të krijuar imunitet - që është shumë i nevojshëm, duke ditur rrethanat në vend”.*

Kryesorja në sigurimin e lirisë dhe objektivitetit gazetaresk, sipas bashkëbiseduesve, është krijimi i një identiteti të veçantë mediatik dhe ndarja e strukturave



drejtuese nga aspekti gazetaresk dhe programor. Një ndarje e tillë do të sigurojë që mediat mund të funksionojnë në mënyrë efikase, pa ndikim nga qendrat politike apo të biznesit.

Shkurtimisht, palët e interesuara e shohin integritetin mediatic si një fenomen kompleks që kërkon një ekuilibrim të pavarësisë, profesionalizmit, objektivitetit dhe transparencës. Ky ekuilibri është thelbësor për mediat që t'i shërbejnë në mënyrë efektive interesit publik dhe të kontribuojnë për një shoqëri të shëndetshme demokratike.

## Integriteti mediatic në vend është goditur rëndë

Në diskutimet për gjendjen e integritetit mediatic në vend, palët e përfshira tregojnë një peizazh shumëngjyrësh të karakterizuar nga kompleksitete dhe sfida. Sipas vlerësimeve, shumica e faktorëve ndikojnë ndjeshëm në integritetin mediatic dhe në “shëndetin”

e përgjithshëm të industrisë mediatike. *“Situata aktuale me integritetin mediatic në vend është e keqe dhe është pasojë e mungesës prej tre dekadash të një pjese të madhe të vlerave që duhet ta karakterizojnë atë. Edhe pse ka pasur disa ndryshime viteve të fundit, në të njëjtën kohë mund të flitet për përkeqësim, sepse reformat e premtuara, por të porealizuara në sistemin mediatic, në thelb shkaktojnë prapambetje ose gjenerojnë procese retrograde”. “Ne jemi një shoqëri, fatkeqësisht, në të cilën mediave u mungon integriteti, me përjashtime. Kjo është kështu sepse ka dukuri që kalojnë ndër vite dhe mbeten, fasadën e kemi pak më ndryshe. Është e vërtetë që RMV-ja po përparon në listat mediatike për lirinë e shprehjes, por klientelizmi nuk është çrrënjësor, ka ekzistuar dhe do të ekzistojë, është një mënyrë funksionimi në media”.*

Një çështje kritike në lidhje me integritetin mediatic janë linjat e paqarta ndërmjet pronësisë së mediave dhe politikës

redaktuese. Kjo përzjerje e roleve çon në shqetësime për manipulimin e përmbajtjes dhe, si rezultat i kësaj disa, gazetarë perceptohen sikur u shërbejnë qendrave e jo interesit publik. *“Ndikimet politike dhe ndikimet e pronarëve, së bashku me kufizimet ekonomike, kanë çuar në një ulje të besimit dhe ndjekjes së mediave”. “Të shtypur nga interesat politike dhe të biznesit, një numër i konsiderueshëm redaksish raportojnë informacione pa analizë apo kontekst kritik, duke dështuar të mbrojnë interesin publik”.*

Integriteti i dëmtuar mediatik lidhet edhe me përkeqësimin e statusit social-ekonomik të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë.

Edhe faktorë të tjerë e bëjnë të pamundur ose paraqesin sfida shtesë për integritetin mediatik sot. *“Këtu, para së gjithash, do t’i veçoja ndryshimet tektonike në industrinë mediatike që solli përdorimi masiv i internetit dhe eksplodimi i rrjeteve sociale, të*

*cilat morën rolin e “ndërmjetësit” në transmetimin e informacionit tek publiku”. “Industria mediatike është, në të njëjtën kohë, nën sulmin e industrisë së prodhimit të dezinformatave për të cilën flasin edhe “Reporterët pa Kufij” në Indeksin e tyre të fundit. Hapësira mediatike është e bombarduar me “të vërteta alternative” që krijojnë konfrontim dhe polarizim, duke rezultuar në apati tek një pjesë e madhe e audiencës së pavendosur politikisht dhe largim nga media - gjë që vihet në dukje prej disa vitesh, sipas hulumtimit të Institutit Reuters pranë Universitetit të Oksfordit”. “Në raportin e Priebe-s kishte një diagnozë të qartë për gjithë sektorin mediatik me anomali që pengojnë zhvillimin e shoqërisë në drejtim demokratik. Atëherë ky sektor ishte i pushtuar nga partia në pushtet përmes mekanizmave të reklamave shtetërore dhe në mënyra të ndryshme, ndaj redaksitë, tekstualisht, ishin të ngulfatur. Ky sektori është çliruar nga ai ndikim, por disa*

*anomali sistemike nuk janë zgjidhur, kryesisht të lidhura me statusin socio-ekonomik të gazetarëve”.*

## Zbërthimi i sfidave në lidhje me integritetin në media

Siç theksuam tashmë, shumë faktorë kontribuojnë në sfidat që lidhen me integritetin e mediave. Të gjithë të intervistuarit pajtohen se vështirësitë ekonomike janë një faktor i fortë. Njëkohësisht, shumë subjekte mediatike mbështeten në strategji për realizimin e të ardhurave të shpejta, që i komprometojnë standardet gazetareske. Kjo paqëndrueshmëri ekonomike shpesh çon në një ngatërrim të pronësisë së mediave dhe kontrollit në politikat redaktuese, ku pronarët ndikojnë në përmbajtje për përfitime politike, personale ose komerciale. Ky përqendrim i pronësisë së mediave e kërcënon diversitetin dhe pluralizmin mediatik.

Gazetarët përballen me presion nga pronarët dhe interesat e biznesit, duke çuar në autocensurë dhe shmangie të temave që mund t'i ofendojnë subjektet e fuqishme. *“Ky fenomen ka sjellë ndryshime në përmbajtjen mediatike, ku pseudo-ngjarjet me truke marketingu apo PR-i i zëvendësojnë shpeshherë me lajmet reale, duke i thyer kodet gazetareske”.*

Rolet e ndërthurura të drejtorit dhe kryeredaktorit në shumë media i mjegullojnë më tej kufijtë midis interesave afariste dhe pavarësisë redaktuese. Kjo konvergencë e roleve e komprometon integritetin e përmbajtjes gazetareske, ku redaktorët shpeshherë lëshojnë penj ndaj presioneve menaxheriale ose pronësore.

Varësia nga financimi politik e dëmton pavarësinë ekonomike të mediave, duke ndikuar në politikat redaktuese dhe duke i lejuar aktorët politikë të ndikojnë drejtpërdrejt në narracionet mediatike.

Kulmi i kësaj, rritja e dezinformatave, e përforcuar nga përdorimi i kudondodhur i mediave sociale, po ndikon negativisht në praktikat tradicionale gazetareske. Një ambient i tillë e bën të vështirë ruajtjen e integritetit të mediave profesionale në kushte të përhapjes së të vërtetave alternative dhe sensacionit.

Situata rëndohet edhe më shumë nga tregu i vogël dhe numri i madh i mediave - gjë që çon në “shitjen e integritetit” tek elitat politike dhe të biznesit. Tregu mediatik maqedonas ka qenë i ngopur që nga fillimi i zhvillimit të tij në gjysmën e parë të viteve 1990-ta. Nuk pati përpjekje për konsolidimin rregullator të tregut dhe reduktimin e tij në numrin e “lojtarëve” që ai mund të mbështeste, duke siguruar një cilësi më të lartë të programeve dhe përmbajtjeve të ofruara për shikuesit. Që në fillim u miratua politika që për këtë do të kujdesej “dora e tregut” vetërregulluese dhe se ata që nuk mund të përballonin luftën konkurruese

do të mbylleshin dhe zhdukeshin shpejt<sup>64</sup>.

Reklamat politik me disa milionë euro në çdo cikël zgjedhor i forcon më tej marrëdhëniet klienteliste, jo vetëm me partinë në pushtet, por edhe me partitë opozitare. Pavarësia financiare nga qeveria dhe qendrat e pushtetit është thelbësore për ruajtjen e integritetit të medias - një koncept i kërcënuar aktualisht nga reformat e ngecura në media dhe rikthimi i reklamave shtetërore. Sipas ndryshimeve të propozuara në Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, 0,1 për qind e të ardhurave të realizuara në buxhetin e shtetit për vitin e fundit do të shkojnë për financimin e fushatave shtetërore, për të cilën gjë do të vendosë një komision i përbërë nga përfaqësues të partive politike, nga tre përfaqësues nga

64 Qendra për Zhvillimin e Mediave, 2020. Si të konsolidohet tregu i shërbimeve mediatike audiovizuale. Në dispozicion në: <https://mdc.org.mk/kako-do-konsolidacija-na-pazarot-na-audiovizuelni-mediumski-uslugi>

pushteti dhe opozita<sup>65</sup>. Kjo është në përputhje me zgjidhjen ligjore të dorëzuar në Kuvend.

Gazetarët në redaksi shpeshherë ndihen të pasigurt lidhur me statusin e tyre, gjë që ndikon në ndjenjën e tyre të pavarësisë dhe profesionalizmit. Vetë-censurimi e kufizon lirinë e tyre dhe raportimin e pavarur. Frika nga sulmet, presionet dhe kërcënimet ndikon në cilësinë e raportimit dhe shkaktojnë mosbesim në gazetarinë si profesion dhe në punën mediatike në përgjithësi<sup>66</sup>.

Mungesa e gazetarëve të trajnuar siç duhet dhe strategjia e pushtetit për të prodhuar përmbajtje të tyre mediatike që ata ua ofrojnë mediave, e zbeh

më tej thelbin e gazetarisë së pavarur.

Shkurtimisht, sfidat rreth integritetit të mediave në Maqedoninë e Veriut, sipas pjesëmarrësve në hulumtim, janë të rrënjësura thellë në faktorët ekonomikë, politikë dhe socialë. Këto sfida shfaqen në forma të ndryshme, nga përzierja në pronësi, përmes varësisë financiare, deri te presionet politike dhe përhapja e dezinformatave.

65 Stojançova, P. (2023) 'Parti të bashkuara kthejnë reklamat qeveritare', Europa e Lirë. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/slozhni-partii-vladini-reklami-vrakjaat/32687388.html> Qasje prej dt. 16.11.2023

66 Tuneva, M., Sandev, L. 2022. Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë: realitet apo kërcënim i vazhdueshëm. Në dispozicion në: [https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/MK\\_Bezbednost-na-novinarite-i-mediumskite-rabotnici-130322.pdf](https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/MK_Bezbednost-na-novinarite-i-mediumskite-rabotnici-130322.pdf) Qasje prej dt. 14.11.2023.



### **Mediat online në tranzicion: sfidat rregullatore dhe ndërtimi i integritetit**

Një çështje kyçe në kuadër të sektorit të mediave-online, sipas të bashkëbiseduesve, është mungesa e transparencës në lidhje me strukturat e pronësisë dhe metodat e financimit. Kjo jo vetëm që nxit mosbesimin tek publiku, por edhe e rrënon integritetin mediatik.

Korniza juridike konsiderohet e vjetërsuar, duke i favorizuar në mënyrë disproporcionale mediat tradicionale. Ligjet aktuale për media konsiderohen si joadekuate për t'u përballur me specifikat dhe sfidat e mediave online. Prandaj, Shoqata e Mediave Online propozon ndryshime urgjente në Ligjin për Media, të cilat kërkojnë përfshirjen e qartë të mediave online në përkufizimin për mediat.

Në procesin e harmonizimit të legjislacionit, pritet një balancim ndërmjet nevojës për mbikëqyrje rregullatore dhe ruajtjes së lirisë së gazetarisë dhe shprehjes në hapësirën online. ***“Duhet kuptuar se pa një industri të fortë mediatike, në të cilën mediat online kryesojnë dhe do të vazhdojnë të udhëheqin, nuk ka media me integritet dhe nuk ka gazetari rezistuese ndaj presionit, censurës, klientelizmit dhe kompromiseve. Shteti nuk do të jetë në gjendje të shpëtojë të ashtuquajturat media tradicionale në një mënyrë që do t’u japë atyre para për të mbuluar humbjet e tyre dhe, veçanërisht, pamundësinë e pronarëve të mediave për t’u reformuar dhe përshtatur me sfidat e tregut. Shtypi duhet të gjejë të ashtuquajturat “tregje” dhe t’u përshtatet atyre, ndërkohë që televizionet duhet të fokusohen në zhvillimin e video-produksioneve, për të cilat do të sigurojnë mbështetje legjitime financiare nga subjekte të fuqishme ekonomike. Këto janë tendencat në rajon, por edhe më gjerësisht në Europë”.***

## Roli i mediave në nxitjen e përfshirjes dhe përfaqësimit në Maqedoninë e Veriut

Në indin e larmishëm shoqëror të Maqedonisë së Veriut, në të cilin bashkëtojnë grupe të ndryshme etnike dhe kulturore, mediat luajnë një rol kyç në promovimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe gjithëpërfshirjes sociale. Integriteti mediatik, në këtë kontekst, e përfshin përgjegjësinë për përfaqësim të drejtë dhe të saktë të të gjitha segmenteve të shoqërisë.

Bashkëbiseduesit vlerësojnë se mediat, veçanërisht shërbimi publik, kanë një rol kyç në afirmimin e diversitetit në shoqëri, por edhe në formësimin e perceptimit publik për barazinë gjinore. Në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2022-2027<sup>67</sup>, po ashtu janë përcaktuar edhe prioritetet për mediat. Theksohet nevoja e promovimit të barazisë gjinore duke paraqitur shembuj pozitivë,

<sup>67</sup> Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. *Strategjia e Barazisë Gjinore 2022 – 2027*. Në dispozicion në: <https://bit.ly/3NqNsJE>

angazhimi më i shpeshtë i grave si bashkëbiseduese në debate dhe programe të tjera me të ftuar, si dhe përfaqësim më i madh i përmbajtjeve që trajtojnë tema të barazisë gjinore, respektivisht duke përfshirë aspektin gjinor në numrin më të madh të temave që trajtohen në media.

Përgjegjësia e mediave nënkupton tejkalimin e stereotipave, promovimin e të drejtave themelore të njeriut dhe ndërgjegjësimin për çështjet e barazisë gjinore, përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, rëndësinë e komunikimeve ndërkulturore, etj. Qasja e mediave ndaj këtyre çështjeve mund të ndikojë ndjeshëm në qëndrimet dhe sjelljet shoqërore.

Mbulimi i rregullt dhe i saktë i këtyre temave ka rëndësi thelbësore për krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse. Për të garantuar përmbushjen e interesit publik, është imperativ të integrohet gjithëpërfshirja në politikat dhe praktikat mediatike. Ky integrim, sipas të intervistuarve, përfshin jo vetëm

zgjidhjen e përfaqësimit në përmbajtjet mediatike, por edhe promovimin e diversitetit brenda fuqisë punëtore të mediave. Duke vepruar kështu, mediat mund të luajë një rol kyç në tejkalimin e ndarjeve shoqërore, nxitjen e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe promovimin e një diskursi publik më gjithëpërfshirës në vend.

## Roli i mediave në luftën kundër korrupsionit: sfidat dhe përgjegjësitë

Bashkëbiseduesit e intervistuar theksojnë se integriteti mediatik është i lidhur, në masë të madhe, me rezistencën ndaj korrupsionit. ***“Etika dhe korrupsioni nuk e kanë shenjën e barazisë”.*** Detyrimi parësor i mediave duhet të jetë zbulimi i abuzimeve me fuqinë, shpërdorimi i fondeve publike dhe marrëdhënieve klienteliste, që është guri themeltar i funksionimit të sistemeve ligjore. ***“Kemi problem të madh që një pjesë e madhe e mediave nuk e kanë ndërtuar rolin e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe nuk flasin në***



*interes të publikut, heshtin, nuk komentojnë, rrinë anash".* Marrja e fondeve shtetërore për reklamat paraqet një sfidë të rëndësishme për sa i përket integritetit të mediave. *"Me propozim-ligjin në Kuvend, me të cilin propozohet që të gjitha mediat private të marrin para, vendoset korrupsioni sistemik. Kurdo qoftë do ta hedhin në votim Ligjin. Nuk ka integritet kur kaq shumë media private financohen nga paratë publike për reklama të institucioneve. Nuk ka vend për gazetari, profesionalizëm dhe integritet".*

Për ballafaqim me korrupsionin në media, sipas disa bashkëbiseduesve, të rëndësishme janë praktikat e brendshme në redaksi. Qartësia e brendshme e parimeve të punës dhe përkushtimi për të luftuar korrupsionin në organizatat mediatike janë me rëndësi vitale. Kjo përfshin krijimin e kanaleve për sinjalizim dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. *"Një nga zgjidhjet e mundshme për përmirësimin e integritetit të mediave është*

*vendosja e pikave të kontaktit të brendshëm në organizatat mediatike. Ato do të shërbejnë si mundësi për qytetarët që të raportojnë çështje etike apo probleme që lidhen me funksionimin e mediave, gjë që do të nxisë komunikimin e dyanshëm dhe angazhimin e audiencës".* *"Nuk mund të flasësh për korrupsion jashtë nëse nuk je mjaftueshëm transparent për atë që po ndodh në redaksi. Nga njëra anë mbron interesin publik, kurse nuk ke guxim për transparencë mbi pronësinë, pagat...".*

*"Për më tepër, vetë Autoriteti Rregullator duhet të jetë më i aksesueshëm për qytetarët, duke u mundësuar atyre që të raportojnë dyshime për korrupsion në media. Mekanizma të tillë do të mbrojnë anonimitetin e parashtruesve të ankesave dhe do të përmirësojnë potencialisht besimin e publikut në media".*

Gazetaria hulumtuese, veçanërisht nga platformat online dhe mediat e krijuara nga qytetarët, luan një rol kyç në luftën kundër korrupsionit. *“Efektiviteti i mediave në luftën kundër korrupsionit është i lidhur ngushtë me funksionimin e sistemeve gjyqësore. “Pa pasoja juridike për korrupsionin e zbuluar, përpjekjet e mediave rrezikojnë të bëhen të kota”.*

Potenciali i mediave si mjet në luftën kundër korrupsionit varet nga integriteti i tyre personal. Nëse sistemi mediatik nuk arrin të sigurojë një kornizë për integritetin e mediave, mediat rrezikojnë jo vetëm të bëhen viktimë, por edhe të përjetësojnë korrupsionin brenda radhëve të tyre.

## Konkluzione

**H**ulumtimi mbi gjendjen e integritetit të mediave në vend zbulon një mozaik kompleks sfidash. Në qendër të këtyre sfidave është gërshetimi i pronësisë së mediave me aspektin redaktues në redaksi. Kjo shkakton shqetësime serioze për pavarësinë e gazetarisë, prandaj ekziston nevoja për të vendosur një dallim të qartë midis pronësisë dhe kontrollit redaktues për hir të integritetit gjatë raportimit.

Sa i përket situatës ekonomike, varësia e mediave nga reklamat politike dhe shtetërore shpeshherë e komprometon pavarësinë redaktuese, duke nënvizuar nevojën kritike për stabilitet financiar që nuk do të dëmtojë lirinë e mediave. Arritja e këtij ekuilibri është jetike për ruajtjen e një mjedisi mediatik që do të jetë konsekuente me parimet e paanësisë.

Konfirmohet se është gjithashtu e rëndësishme të përforcohet kuadri rregullator (i ashtuquajtur "rregullim i butë") për mediat online, duke siguruar

transparencë dhe përgjegjësi të qartë. Është gjithashtu e rëndësishme të zhvillohet edhe korniza vetërregulluese si bazë për promovimin e standardeve etike dhe profesionale në të gjithë sektorët mediatikë.

Një dimension i rëndësishëm i integritetit të mediave është gjithëpërfshirja dhe diversiteti, veçanërisht në aspektin e përfaqësimit gjinor. Përgjegjësia e mediave shtrihet përtej raportimit të thjeshtë; është e nevojshme të pasqyrohen zërat dhe përvojat e ndryshme në shoqëri. Kjo nënkupton përfaqësim të drejtë dhe objektiv të gjinisë dhe komuniteteve të ndryshme në përmbajtjet mediatike, tejkalimin e stereotipave dhe promovimin e të drejtave themelore të njeriut. Integrimi i barazisë gjinore në politikat dhe praktikat e mediave nuk është vetëm një çështje e gazetarisë etike, por edhe thelbësore për nxitjen e një diskursi publik më gjithëpërfshirës dhe të balancuar. Për më tepër, përmirësimi

i statusit socio-ekonomik të gazetarëve dhe ngritja e kapaciteteve të tyre është thelbësore për ruajtjen e standardeve dhe etikës së lartë gazetareske. Përmirësimi i kushteve të punës dhe sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional janë thelbësore për të nxitur një ambient mediatik që vlerëson integritetin, gjithëpërfshirjen dhe raportimin etik.

Autoritetet vetërregulluese, në bashkëpunim me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të promovojnë rolin e vetërregullimit dhe ekzistencën e mekanizmave vetërregullues, përmes fushatave informuese, trajnimeve, edukimit dhe ngjarjeve dhe aktiviteteve të tjera për të rritur ndërgjegjësimin publik në segmente të ndryshme të publikut. Përveç përmirësimeve rregullatore, ekziston një nevojë urgjente për përmirësimin e edukimit mediatik. Edukimi i publikut se si të dallojë informacionin e besueshëm dhe gënjeshttrat është thelbësor për ndërtimin e një publiku më të informuar.

Shkurtimisht, rruga drejt forcimit të integritetit të mediave në Maqedoninë e Veriut përfshin ballafaqimin e drejtpërdrejtë me këto sfida të shumëanshme. Duke u fokusuar në këto fusha kritike, mjedisi i mediave do të evoluojë në një hapësirë që nuk është vetëm e pavarur dhe transparente, por gjithashtu pasqyron diversitetin e shoqërisë dhe është e angazhuar për respektimin e parimeve të demokracisë dhe mirëqenies publike.



## Rruga drejt integritetit të mediave

### rekomandime

**N**ë këtë pjesë të dokumentit, i sintetizojmë njohuritë e marra nga analiza në një grup rekomandimesh që janë formuluar në një mënyrë që ato të mund të zbatohen në aspekte të ndryshme të sektorit

mediatik. Çdo rekomandim është gjithashtu edhe thirrje për veprim, respektivisht një ftesë për të gjitha palët e interesuara që të luajnë rolin e tyre në përf forcimin e integritetit të mediave.

## Avancimi i integritetit të mediave: iniciativa për pavarësi dhe harmonizim me standardet europiane

- ▶ Themelimi i një Fondi për mbështetjen e mediave (fondi i gazetarisë hulumtuese) bazuar në kriteret objektive, duke garantuar pavarësinë dhe harmonizimin me standardet europiane. Ky fond duhet të mbështesë gazetarinë në interes të publikut, pavarësisht nga ndikimi i qendrave të ndryshme të fuqisë.
  - ▶ Sigurimi i financimit të qëndrueshëm të Shërbimit të transmetimit publik.
  - ▶ Rishikimi i rregullave për përqendrimin e pronësisë për të përmirësuar pluralizmin mediatik dhe pavarësinë redaktuese.
  - ▶ Harmonizimi i formave të mbështetjes shtetërore për mediat me rregullativën europiane dhe dispozitat në Aktin e Lirisë së Mediave, propozuar nga Komisioni Europian.
- ▶ Ndërmarrja e hapave për zhvillimin e mediave të komunitetit dhe afirmimin e sektorit mediatik jofitimprurës.
  - ▶ Rivendosja e garancive ligjore për zgjedhjen e pavarur të kryeredaktorëve dhe drejtorëve të redaksive në Ligjin për Media.
  - ▶ Miratimi i akteve të brendshme në media me të cilat do të sigurohet ndarja e redaksive nga ndikimet pronësore dhe drejtuese.
  - ▶ Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave<sup>68</sup>, të vendoset detyrimi ligjor për institucionet e sektorit publik dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore për të shpallur publikisht kontratat e lidhura të çdo lloji me të gjitha mediat dhe për të forcuar kriteret për ndarjen e ndihmës shtetërore për mediat e shtypura.

68 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 2021. Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave. Në dispozicion në: <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategjia-DKSK-KONECNA.pdf>

## Reforma etike, arsimore dhe strukturore për gazetari të përgjegjshme

- ▶ Krijimi dhe zbatimi i mekanizmave të brendshëm për zgjidhjen e çështjeve etike dhe problemeve operative, duke e lehtësuar pjesëmarrjen e publikut në monitorimin e punës së mediave.
- ▶ Ofrimi i edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e mediave për të qenë në hap me progresin në industri, duke u fokusuar në prodhimin e përmbajtjeve të ndryshme dhe gjithëpërfshirëse.
- ▶ Zhvillimi dhe mirëmbajtja e mekanizmave të brendshëm për zgjidhjen e dilemave etike dhe sfidave operative në vetë redaksitë.
- ▶ Vendosja e një mekanizmi në vetë redaksitë për t'u marrë me ankesat e publikut.
- ▶ Unifikimi i mediave me qëllim të veprimt të koordinuar në emër të interesit publik përmes projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- ▶ Angazhimi aktiv i menaxhmentit të mediave për t'u njohur me rregullativat dhe praktikat më të fundit në lidhje me zhvillimin e industrisë. Në këtë drejtim rekomandohet bashkëpunimi i rregullt dhe më aktiv me Rregullatorin e Mediave, Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, si dhe me organizatat dhe shoqatat profesionale mediatike dhe gazetareske.
- ▶ Përfshirja e redaksive në përmirësimin e edukimit mediatik mes qytetarëve, gjë që do t'u mundësojë atyre të bëjnë një dallim të qartë midis përmbajtjes së besueshme gazetareske dhe dezinformatave.
- ▶ Promovimi i barazisë gjinore në programe dhe përmbajtje dhe përfaqësim më i madh i grave në poste drejtuese në media.
- ▶ Krijimi dhe mbajtja e një kuadri bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shkencore, organizatave dhe shoqatave mediatike dhe mediave për të forcuar integritetin mediatik. Një

bashkëpunim i tillë mund të përfshijë gjithashtu seminare të përbashkëta, programe trajnimi dhe krijimin e burimeve, ku vetë profesionistët e mediave mund të edukohen mbi parimet shkencore, interpretimin e të dhënave dhe analizën kritike të informacioneve shkencore. Iniciativa të tilla do t'u mundësonin gazetarëve të raportojnë në mënyrë më efektive për tema komplekse shkencore në një mënyrë të kuptueshme dhe të përgjegjshme.

- ▶ Organet vetërregulluese, në bashkëpunim me organizatat mediatike dhe të shoqërisë civile, të promovojnë vazhdimisht rolin e vetërregullimit dhe ekzistimin e mekanizmave vetërregullues, përmes fushatave informuese, trajnimeve, edukimit dhe ngjarjeve të tjera.

## Përmirësimi i kushteve socio-ekonomike dhe kornizës juridike

- ▶ Ndryshime në legjislacionin ekzistues të mediave me qëllim sigurimin e mbrojtjes së veçantë të të drejtave sociale dhe të punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Legjislacioni duhet të harmonizohet me dispozitat e Rregullores së BE-së për Lirinë e Mediave, rekomandimet e KE-së nr. 6650 të vitit 2021 dhe nr. 1634 të vitit 2022, si dhe me Kartën e të Drejtave të Punës të Federatës Europiane të Gazetarëve<sup>69</sup>.
- ▶ Mediat duhet të kenë akte të brendshme që i rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet pronarëve, menaxhmentit

<sup>69</sup> Ky është një nga konkluzionet e seminarit të reformave në mediave, i mbajtur në tetor 2023, si pjesë e Fazës së Dytë të projektit të BE-së për lirinë e shprehjes: harmonizimi i legjislacionit kombëtar për mediat me të drejtën e BE-së dhe standardet mediatike europiane.



dhe gazetarëve. Gazetarët dhe punonjësit e mediave duhet të kenë kontrata pune që u garantojnë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës<sup>70</sup>.

- ▶ Është jashtëzakonisht e rëndësishme të mbështetet organizimi sindikalist i gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe për lidhjen e marrëveshjeve kolektive. Rekomandohet që të ndiqet shembulli i disa vendeve europiane (Danimarka), ku në marrëveshjet kolektive sigurohet mbrojtja e të drejtave të punëtorëve dhe të gazetarëve të angazhuar me honorar dhe punonjësve mediatikë.<sup>71</sup>

<sup>70</sup> Ibid

<sup>71</sup> Ibid



# BIBLIOGRAFIA

## Libra dhe kapituj

Esch, V. and Palm, V., 2021. Media Freedom in the Western Balkans. Aspen Institute Germany. Në dispozicion në: [https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021\\_Aspen-Germany\\_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf](https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021_Aspen-Germany_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf)

Nehring, C. (ed.) 2023. Blurring the Truth: Disinformation in South East Europe. [online] Në dispozicion në: <https://www.kas.de/documents/281902/281951/E-book+Blurring+the+Truth.pdf/fd6abbb3-f49e-115b-090e-7c9f3a20dfc6?version=1.2&t=1680504776349>

Petkovic, B. (2014). *Media Integrity Matters - Reclaiming Public Service Values in Media and Journalism*. [online] Peace Institute Ljubljana. Në dispozicion në: <https://seenpm.org/media-integrity-matters-book-of-the-see-media-observatory/>

Stojanovski, F. (ed.) 2022. Research: The Effects of Disinformation and Foreign Influences on the Democratic Processes in North Macedonia. Skopje: Metamorphosis Foundation. Në dispozicion në: <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/themes/metamorphosis/download.php?id=34783>

S. Trpevska & I. Micevski, Media Sector Hotspots in North Macedonia: Decisive Reforms Long Overdue, ASPEN Institute Germany, December 2021, p.32. Available at: [https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021\\_Aspen-Germany\\_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf](https://www.aspeninstitute.de/wp-content/uploads/2021_Aspen-Germany_Media-Freedom-in-the-Western-Balkans.pdf)

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, 2023. *Liria e mediave në Maqedoninë e Veriut: progres në këmbë të qelqta*. Në dispozicion në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/10/EN-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web.pdf>

Micevski, I. 2019. *Gjinia në media 2019: Analizë e aspekteve gjinore në programet për fëmijë në televizionet nacionale terestriale*. Në dispozicion në: <https://resis.mk/attach/rodot-vo-mediumite-2020.pdf>

Nikodinoska, V. 2020. *Baza politike dhe ekonomike e mediave dhe modeleve të komunikimit që përhapin dezinformata dhe gjuhë të urrëjtjes*. Instituti Maqedonas për Media. Në dispozicion në: <https://mim.org.mk/attachments/article/1230/Mediumski%20i%20komunikaciski%20modeli%20koi%20shirat%20dezinformacii%20i%20govor%20na%20omraza.pdf>

RESIS, 2023. Media e komunitetit – nxitje alternative për demokracinë pluraliste lokale. Në dispozicion në : [https://resis.mk/images/about-us/PDF/001com\\_media\\_policy\\_brief.pdf](https://resis.mk/images/about-us/PDF/001com_media_policy_brief.pdf)

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë (SPGPM), Përse ikin gazetarët nga profesioni. [online] Në dispozicion në: <https://bit.ly/315aZWW>

Tuneva, M. and Boshkova, H., 2023. *Raportimi etik për dhunën me bazë gjinore në Maqedoninë e Veriut* Res Publica. Në dispozicion në: <https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2023/10/etichko-izvestuvanje-za-rodovo-baziranoto-nasilstvo-mk-1.pdf>

Tuneva, M., Nikodinovska, V., 2023. *Përforcimi i domosdoshëm i mekanizmave dhe avancimi i efikasitetit: Vetë-rregullimi i mediave në Maqedoninë e Veriut*. Instituti Maqedonas për Media

Tuneva, M., Sandev, L. 2022. Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë: realitet apo kërcënim i vazhdueshëm. Në dispozicion në: [https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/MK\\_Bezbednost-na-novinarite-i-mediumskite-rabotnici-130322.pdf](https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/MK_Bezbednost-na-novinarite-i-mediumskite-rabotnici-130322.pdf)

Qendra për Zhvillimin e Mediave, 2020. Si të konsolidohet tregu i shërbimeve mediatike audiovizuele. Në dispozicion në: <https://mdc.org.mk/kako-do-konsolidacija-na-pazarot-na-audiovizuelni-mediumski-uslugi>

## Dokumente dhe raporte

Centre for Media Pluralism and Media Freedom, 2023. Media Pluralism Monitor 2023. [online] European University Institute. Në dispozicion në: <https://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor-2023/>

Committee of Ministers of the Council of Europe, 1999. Recommendation No. R (99) 1 on Measures to Promote Media Pluralism. [online] Në dispozicion në: <https://rm.coe.int/16804fa377>

Committee of Ministers of the Council of Europe, 2018. Recommendation CM/Rec(2018)1 on Media Pluralism and Transparency of Media Ownership. [online] Në dispozicion në: [https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset\\_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2018-1-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-media-pluralism-and-transparency-of-media-ownership](https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2018-1-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-media-pluralism-and-transparency-of-media-ownership)

Council of Europe. Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention). Në dispozicion në: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/text-of-the-convention>

European Commission, 2022. *North Macedonia Report 2022*. [online] Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/48ba61f0-41ae-4cff-9517-29fac190f4bd\\_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202022.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/48ba61f0-41ae-4cff-9517-29fac190f4bd_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202022.pdf)

European Commission, 2015. Prioritetet urgjente të reformave për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Urgent Reform Priorities for the Former Yugoslav Republic of Macedonia). Në dispozicion në: [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent\\_reform\\_priorities\\_mk.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_mk.pdf)

European Commission, 2023. North Macedonia 2023 Report. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_693%20North%20Macedonia%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf)

European Commission, Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations, 2023. MK Cluster 1 Draft Screening Report. Në dispozicion në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/MK%20Cluster\\_1%20Draft%20screening%20report\\_external%20version.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/MK%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf)

European Parliament, 2023. European Media Freedom Act. Në dispozicion në: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0336\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0336_EN.pdf)

European Union, 2022. Commission Recommendation of 14.9.2022 on the protection, safety and empowerment of journalists and other media professionals (2022/C 346/01). *EUR-Lex*. [online] Në dispozicion në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32022H1634>

Freedom House, 2023. North Macedonia: Nations in Transit 2023. Në dispozicion në: <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/nations-transit/2023>

Freedom House, 2022. North Macedonia: Freedom in the World 2022 Report. Në dispozicion në: <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/freedom-world/2022>

International Press Institute, 2023. Policy Paper: Support for Public Interest Journalism in North Macedonia. [online] Në dispozicion në: <https://ipi.media/policy-paper-support-for-public-interest-journalism-in-north-macedonia/>

Parliamentary Assembly of the Council of Europe, 2008. Resolution 1636 (2008) Në dispozicion në: <https://assembly.coe.int/nw/xml/xref/xref-xml2html-en.asp?fileid=17684&lang=en>

Reporters Without Borders (RSF), North Macedonia. Në dispozicion në: <https://rsf.org/en/country/north-macedonia>

Reporters Without Borders (RSF), North Macedonia. [online] Në dispozicion në: <https://rsf.org/en/country/north-macedonia>

UNESCO, 2017. Providing Public Funding for Community Broadcasting. Community Media Sustainability Policy Series, 5. [online] Në dispozicion në: [https://en.unesco.org/sites/default/files/unesco\\_cmedia\\_sustainability\\_policy\\_5\\_public\\_funding.pdf](https://en.unesco.org/sites/default/files/unesco_cmedia_sustainability_policy_5_public_funding.pdf)

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 2021. Strategjia Kombëtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Në dispozicion në: <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategjia-DKSK-KONECNA.pdf>

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë,  
2023. Fact-Finding PFM Report. Në  
dispozicion në: [https://znm.org.mk/  
wp-content/uploads/2023/10/EN-Fact-  
Finding-PFM-Report-251023-web.pdf](https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2023/10/EN-Fact-Finding-PFM-Report-251023-web.pdf)

Ministria e Punës dhe Politikë Sociale.  
Strategjia e Barazisë Gjinore. Në  
dispozicion në: <https://bit.ly/3NqNsje>

Këshilli për Etikë në Media, Udhëzime  
për raportim etik të mediave online.  
Në dispozicion në: [https://semm.  
mk/dokumenti/korisni-resursi/  
kodeks/850-nasoki-za-etichko-  
izvestuvanje-na-onlajn-mediumite](https://semm.mk/dokumenti/korisni-resursi/kodeks/850-nasoki-za-etichko-izvestuvanje-na-onlajn-mediumite)

## Artikuj

European Federation of Journalists (EFJ), 2019. North Macedonia: EFJ welcomes initiative aiming to strengthen self-regulation. [online] 19 December 2019. Në dispozicion në: <https://europeanjournalists.org/blog/2019/12/19/north-macedonia-efj-welcomes-initiative-aiming-to-strengthen-self-regulation/>

Aleksandar Atanasov, 2021. MMA: Qeveria të përgatitë propozim-ndryshim të nenit 102 të Ligjit për Media dhe ta dorëzojë në Kuvend. *Agjenci informative mediatike*. [online] <http://bit.ly/41eidhE>

AION, 2023. Shoqata Onlinemedia: Të hiqet kufizimi për financimin zgjedhor të portaleve të internetit. 9 nëntor 2023. Në dispozicion në: <https://aion.mk/macedonia/zdruzhenie-onlajnmedia-da-se-ukine-ogranichuvanjet-za-izbornofinansiranje-na-internet-portalite/>

Vasilevska, M. 2023. *Dr. Tërpevska: Akti i ri i BE-së duhet të rregullojë edhe marrëdhëniet ndërmjet mediave dhe platformave digjitale*

*dhe rrjeteve sociale që kanë marrë rolin e rojtarëve*, 18 shkurt, 2023, në dispozicion në: <https://racin.mk/intervju/d-r-trpevska-noviot-akt-na-eu-treba-da-gi-uredi-i-odnosite-megu-mediumite-i-digitalnite-platformati-i-socizijalni-mrezhi-koi-si-ja-prezedoa-ulogata-na-gejtkiperi/>

Nastoski, Zh. 2023. Reklamat shtetërore në media sjellin dëme të drejtpërdrejta dhe të pariparueshme. *Samoprasaj.mk*. [online] Në dispozicion në: <https://samoprasaj.mk/naacik/drzavnite-reklami-vo-mediumite-nosat-direktna-i-nepopravлива-steta/> Qasur prej dt. 24.11.2023.

Stojançova, P., 2023. Parti të bashkuara kthejnë reklamat qeveritare. *Radio Europa e Lirë*, 16 nëntor 2023. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/slozhni-partii-vladini-reklami-vrakjaat/32687388.html> Më dt. 08.10.2023





Udhëzuesi për integritetin e mediave në Maqedoninë e Veriut është përpiluar në kuadër të projektit "Kaloni informacionin e rremë", i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetjen financiare të Danimarkës, Luksemburgut, Republikës së Koresë dhe Suedisë, në kuadër të programit UNDP Funding Windows. Ky aktivitet i projektit realizohet në partneritet me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.



